



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi
Mbledhja nr. 01 -2009
Prishtinë, më 20 janar 2009, ora 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi

Në mbledhje morën pjesë: Bahri Hyseni, Adem Salihaj, Ramadan Gashi, Kolë Berisha, Armend Zemaj, Ibrahim Makolli, Džezair Murati, Bajram Kosumi dhe Adem Hajdaraj.

Munguan: Branisllav Grbiq dhe Selvije Halimi.

Të pranishëm: Reshit Gashi – NDI, Lumnije Murati – ZPRK, Lejla Selimi, Ramadan Islami dhe Agnesa Mehmeti – OSBE, Rrezarta Ahmeti KDI-BIRN, Fitore Zeneli – KDI, Guxim Zogaj dhe Arbenita Kryeziu - Organizata e të Rinjve Kundër Diskriminimit dhe Sylë Murati – Kosova Sot.

Nga stafi i Komisionit: Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni dhe Sulltane Gashi.

Mbledhjen e kryesoi Bahri Hyseni, kryetar i Komisionit.

RENDI I DITËS

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 22 dhjetorit 2008;
3. Shqyrtimi i vendimit të kryetarit të Republikës së Kosovës të 13 dhjetorit 2008 për rishqyrtimin e Ligjit për avokatinë nr. 03/L-17;
4. Shqyrtimi i raportit të Panelit Rekrutues për përzgjedhjen e kandidatëve për pozitën e avokatit të popullit;

5. Shqyrtimi i raportit të punës të Komisionit për vitin 2008;
6. Shqyrtimi i Projektregullores së punës të Kuvendit të Kosovës;
7. Shqyrtimi i kërkesës së deputetit Xhavit Haliti lidhur me Rregulloren e punës të Kuvendit;
8. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari në fillim të mbledhjes i përshëndeti të pranishmit dhe i njoftoi për rendin e ditës. E përshëndeti edhe z. Ismet Beqirin, që në këtë takim ishte i pranishëm në cilësinë e kryesuesit të Panelit Rekrutues për përzgjedhjen e avokatit të popullit. Meqenëse Ismet Beqiri mund të ketë edhe obligime të tjera, ne mund të fillojmë me pikën e katërt të rendit të ditës. Ai propozoi që pika e parë e rendit të ditës të jetë shqyrtimi i raportit të Panelit Rekrutues për përzgjedhjen e avokatit të popullit. Këtë propozim e miratuan edhe anëtarët e Komisionit.

4. Shqyrtimi i raportit të Panelit Rekrutues për përzgjedhjen e kandidatëve për pozitën e avokatit të popullit

Kryetari lidhur me shqyrtimin e raportit të Panelit Rekrutues për përzgjedhjen e kandidatëve për pozitën e avokatit të popullit fjalën ia dha z. Ismet Beqiri.

Ismet Beqiri - Falënderoi për fjalën e dhënë, i njoftoi për punën e Panelit dhe i falënderoi edhe anëtarët e tij, si dhe stafin mbështetës, për punën dhe për angazhimin e tyre në këtë proces. Në diskutimin e tij shtoi se për pozitën e avokatit të popullit kanë konkurruar 22 veta, kurse në intervistim janë ftuar 18 veta. Prej tyre njëri është tërhequr. Ai përmendi gjithashtu se gjatë punës së Komisionit kanë qenë të pranishme gjatë gjithë procesit edhe organizatat që e kanë monitoruar këtë proces, si: KMDLNJ-ja dhe Komisariati i Lartë për Refugjatë i OSBE-së. Paneli Rekrutues pas intervistimit të kandidatëve dhe vlerësimit, poentimit të tyre, ka rekomanduar tre kandidatë me numër më të madh të pikëve. Në fund të diskutimit të tij, Ismet Beqiri, i falënderoi edhe një herë të gjithë anëtarët e Komisionit, stafin mbështetës dhe organizatat monitoruese që ishin të kënaqura me këtë proces.

Kryetari - Duke u ndërlidhur me parafolësin, shtoi se ka qenë një përfundim i Kryesisë së Kuvendit që ky panel të përbëhej prej tre anëtarëve të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi dhe prej katër anëtarëve të Komisionit për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione. Theksoi se puna e këtij komisioni ka shkuar shumë mirë. Për këtë çështje u hap debat.

Adem Salihaj - Diskutoi për punën e Panelit. Shtoi se puna është kryer me korrektësi. Procedurat kanë qenë korrekte, ndërsa vlerësimi objektiv. Mendoj se njëri nga tre kandidatët duhet të zgjidhet në një nga seancat e radhës të Kuvendit. Në fund më duhet të shtoj se ne, si Panel Rekrutues, jemi vlerësuar pozitivisht edhe nga organizatat që e kanë monitoruar këtë proces.

Armend Zemaj - Duke u ndërlidhur me parafolësit, theksoi se raporti është i mirë. Po ashtu është bërë një punë e mirë dhe duhet të vlerësohet puna e Panelit Rekrutues për përzgjedhjen e avokatit të popullit.

Kryetari - Shtoi se Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi do t'i rekomandojë kandidatët. Tashmë dihen edhe tre kandidatët e vlerësuar me numër më të madh të pikëve nga Paneli Rekrutues dhe radhitja e tyre bëhet sipas alfabetit. Pyeti a pajtoheni me këta tre kandidatë të propozuar, që ne si Komision t'i rekomandojmë.

Komisioni votoi për këta tre të kandidatë të propozuar.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 22 dhjetorit 2008

Kryetari – I pyeti anëtarët e Komisionit për vërejtje eventuale lidhur me procesverbalin.

Procesverbali u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i vendimit të kryetarit të Republikës së Kosovës të 13 dhjetorit 2008 për rishqyrtimin e Ligjit për avokatinë nr. 03/L-17

Kryetari - Lidhur me shqyrtimin e vendimit të kryetarit të Republikës së Kosovës të 13 dhjetorit për rishqyrtimin e Ligjit për avokatinë nr. 03/L-17, shtoi se duhet të lexohet me vëmendje Kushtetuta e Republikës së Kosovës, - neni 84.6, në të cilin parashihet se kur kryetari ka të drejt ta rikthejë ligjin në rishqyrtim nëse konsideron se janë dëmtuar interesat legjitime të Republikës së Kosovës, të një ose më shumë komuniteteve të saj. Kryetari e lexoi edhe vendimin e kryetarit të Kosovës. Sipas këtij vendimi del se janë shkelur të drejtat e një pjese të qytetarëve. Ai e ngriti dilemën se zyrtarët ligjorë të kryetarit të Kosovës nuk e kanë lexuar në tërësi Ligjin për avokatinë, sepse në nenin 35.2.3 është sqaruar se si bëhet regjistrimi i praktikantit të avokatisë. Kjo referencë duhet të jetë në nenin 6, sepse kjo çështje për avokatinë është irelevante dhe duhet të dallohet se kemi të bëjmë me dy kategori: njëra me regjistrimin si praktikant të avokatisë dhe tjetra me avokatin. Këto dyja nuk janë të njëjta, sepse për të qenë avokat duhet të jepet provimi i jurisprudencës, kurse regjistrimi nuk është fare problem. Kjo është procedurë shumë e thjeshtë.

Ibrahim Makolli - Shtoi se Zyra e Kryetarit ka të drejtë, sepse është përjashtuar një kategori e qytetarëve që nuk punojnë në këto segmente: prokurori, gjykatë dhe administratë publike. Ky nen duhet të sqarohet sa më drejt, sepse cenohen të drejtat e njeriut.

Armend Zemaj - Ishte i mendimit që neni 6.1.4 i Ligjit për avokatinë të riformulohet ose të ndryshohet.

Bajram Kosumi - Duke u ndërlidhur me parafolësit, shtoi se është fjala për dy kategori regjistrash - njëri për avokat dhe tjetri për praktikant - në regjistrin e avokatit.

Adem Salihaj - Shtoi se nëse për avokat neni 6.1.4 nuk është kusht, atëherë duhet të hiqet fare. Por nëse duhet të ketë përvojë, a është e domosdoshme që kjo të jetë vetëm në administratën publike, në prokurori dhe në gjykatë. Kjo çështje duhet të sqarohet për ata që nuk kanë punuar në administratë publike.

Kryetari në përfundim të kësaj pike të rendit të ditës propozoi që neni 6.1.4 të modifikohet dhe për mbledhjen e ardhshme të Komisionit ta kemi edhe propozimin me shkrim. Me këtë propozim u pajtuan edhe anëtarët e tjerë të Komisionit.

5. Shqyrtimi i raportit të punës të Komisionit për vitin 2008

Kryetari në këtë pikë të rendit të ditës shtoi se ky është raport i Komisionit për vitin 2008. Duke bazuar në të, del se Komisioni e ka kryer një punë të madhe.

Shumica e anëtarëve të Komisionit ishin që raporti i punës të shqyrtohet në mbledhjen e ardhshme të Komisionit. Me këtë u pajtuan të gjithë.

6. Shqyrtimi i Projektregullore së punës të Kuvendit të Kosovës

Rreth shqyrtimit të Projektregullore së punës të Kuvendit u pajtuan anëtarët e Komisionit që vërejtjet ose komentet për këtë projektregullore t'i dorëzojnë me shkrim në mbledhjen e ardhshme të Komisionit.

7. Shqyrtimi i kërkesës së deputetit Xhavit Haliti lidhur me Rregulloren e punës të Kuvendit

Komisioni u pajtua të shqyrtohet në mbledhjen e ardhshme të Komisionit kërkesa e deputetit Xhavit Haliti lidhur me Rregulloren e punës të Kuvendit.

8. Të ndryshme

Kryetari në kuadër të kësaj pike e shtroi edhe çështjen e Rezolutës për dënimin e krimeve të komunizmit në Kosovë. Ai tha se posa të merret përfundimi i Komisionit për Buxhet dhe Financa se për të nuk ka implikime buxhetore, do ta procedojmë tutje.

Procesverbali u hartua nga stafi Mbështetës i Komisionit

Kryetari i Komisionit

Bahri Hyseni